

VENDIM
Nr.1309, datë 17.9.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.450, DATË 16.6.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12, 13, e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.450, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronës së paluajtshme shtetërore, me nr.5, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, drejtori i Shërbimit të Trupit Diplomatik dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1.FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta i ndryshuar)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punëve të Jashtme Bashkia/komuna: Tiranë Fusha e përdorimit të pronës: Dhënie me qira për përfaqësitë diplomatike										
Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip.totale e pronës (m ²)	Nga sip.totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shërbime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8380 TR-0-9	1./95	Ndërtesë & Truall	Ambasa Franceze & Konsullorja nr.14 “Rr.Skënderbej“	2027	642.5 & 80	Ambasadë	Ministria e Punëve të Jashtme DSHTD	DSHTD	Përfaqësi dipomatike

